



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.713/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtar, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit Star Brands Company shpk me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Gentiana Behluli, kundër të paditues Agjencia për Pronësi Industriale-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Prishtinë, me bazë juridike: anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.257/23 të datës 05.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Star Brands Company shpk me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.257/23 i datës 05.02.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Me Aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së shkallës së parë, është Refuzuar si e pabazuar Kërkesëpadia e paditësit Star Brands Company shpk me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr.09/23 datës 11.05.2023 i paditurit Agjencia për Pronësi Industriale-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Prishtinë.

Kundër këtij Aktgjykimi, përfaqësuesi i autoizuar i palës paditëse, ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa si e bazuar, kurse aktgjykimi K.A.nr.257/23 i datës 05.02.2024 i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, të prishet dhe lënda ti kthehet ne rishqyrtim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Dhomat e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura Agjencia për Pronësi Industriale-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Prishtinë, me vendimin kontestues përfundimtar në procedurën administrative nr.09/23 të datës 11.05.2023 ka Refuzuar ankesën me nr.protokoli KS/2023-002503 dt.13.04.2023 të paraqitur kundër vendimit nr.KS/2023/1712 dt.15.03.2023 lidhur me aplikacionin KS/M/2021/830, të parashtruar nga paditësi Star Brands Company shpk, dhe ka lënë në fuqi vendimin nr.KS/2023/1712 dt.15.03.2023 të Agjencisë për Pronësi Industriale.

Paditësi Star Brands Company shpk me seli në Prishtinë, ndaj këtij vendimi përfundimtar të paditures, me padin e datës 16.06.2023 ka inicuar në gjykatë, konflikt administrativ kundër të paditures, me të cilën ka kërkuar aprovimin e padis dhe anulimin e vendimit të paditures. Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 24.01.2024 në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe administrimit të provave, me Aktgjykimin KA.nr.257/23 datë 05.02.2024 ka Refuzuar kërkespadin e paditësit me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr.09/23 datës 11.05.2023 i paditurit Agjencia për Pronësi Industriale-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit është referuar në dispozitat e nenit 5 dhe 6 të Ligjit 08/L-075 për Markat Tregtare. Gjykata vlerësoi te pabazuara pretendimet e paditësit sepse janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe provat e administruara. Gjykata duke iu referuar kërkesave ligjore për regjistrimin e markes tregtare gjeti se marka tregtare “star brends company” është markë përshkruese dhe e përgjithshme e cila përbëhet nga fjalët e përgjithshme dhe me asnjë veqori dalluese për mallrat dhe shërbimet ngase përbëhet nga fjalët e rendomta në gjuhë të përditshme të cilat tregojnë cilësi dhe karakteristika të mallrave dhe shërbimeve. Paditësi nuk ka vërtetuar faktin se marka tregtare ka fituar veqori dalluese të mjaftueshëm për të gëzuar mbrojtje, përkatësisht për tu regjistruar si markë tregtare pranë të paditurit.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, këtë qëndrim juridik të gjykatës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore.

Kolegji, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejt ligjin, kur nga provat e administruara në konflikt administrativ ka nxjerr konstatimin se paditësi nuk i është përmbajtur kërkesave ligjore me rastin e aplikimit për regjistrimin e markës tregtare “star brands company”.

Dispozita e nenit 6 te Ligjit 08/L-075 për Markat Tregtare, përcakton: *Marka tregtare nuk do të regjistrohet apo, nëse është e regjistruar, do të shpallet e pavlefshme, nëse:*  
*1.1. shenjat të cilat nuk janë në përputhje me markën tregtare sipas Nenin 5 të këtij ligji;*  
*1.2. shenjat të cilat nuk përmbajnë ndonjë veçori dalluese; 1.3. markat tregtare të cilat*

*përbëhen ekskluzivisht nga shenja ose tregues që mund të përdoren në tregti për të përcaktuar llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin e synuar, vlerën, prejardhjen gjeografike, kohën e prodhimit të mallrave ose të kryerjes së shërbimeve ose për të treguar karakteristika të tjera të mallrave dhe shërbimeve; 1.4. markat tregtare të cilat përbëhen ekskluzivisht nga shenja ose tregues të cilat janë bërë të zakonshme në gjuhën e përditshme ose janë përdorur në mirëbesim (bona fide) dhe që kanë krijuar praktika të zakonshme tregtare;*

Gjatë procedurës së konfliktit administrativ, gjykata e shkallës së parë me të drejt ka nxjerr konstatimin se paditësi nuk ka vërtetuar faktin se kjo markë tregtare ka fituar veçori dalluese të mjaftueshme për të gëzuar mbrojtje juridike përkatësisht për tu regjistruar si markë tregtare.

Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, nuk i aprovoi pretendimet ankimore të paditësit, se vendimi i kontestuar i paditurit është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës administrative të nenit 48 të Ligjit 05/L-031 për PPA, dhe se gjykata e shkallës së parë nuk arsyeton se cilat mallra apo shërbime për të cilat është aplikuar i pershkruan emri “star brands company” shpk. Kolegji, vleroi se arsyetimi i vendimit kontestsues të paditues nuk është i përfshirë me shkelje procedurale apo ligjore, sepse arsyetimi i këtij vendimi administrativ, është i qartë dhe i drejtë, dhe përmban spjegimin e gjendjes faktike mbi të cilën është marrë vendimi, si dhe bazën ligjore të zbatuar. Vet fakti se në aplikacionin për regjistrimin e markës tregtare pranë të paditues, paditësi ka kërkuar mbrojtjen e markes tregtare me përshkrimin e shenjës “star brands company” ku në aplikacion janë të përfshira edhe emërtimet e mallrave klasa 29,30,31,32,33,24, (mallra të rendomta: mishi, peshku, perimet, kafja, qaji, sheqeri, kafshët e gjalla, birrat etj) Kolegji vleroi se e paditura, dhe gjykata e shkallës së parë, kanë zbatuar drejt dispozitat nga neni 5 dhe 6 të Ligjit 08/L-075 për Markat Tregtare, kur ka refuzuar aplikacionin e paditësit për mbrojtjen e markes tregtare “star brands company” për mallrat që nuk posedojnë veçori dalluese, përmbajnë fjalë të rendomta në gjuhë të përditshme.

Andaj Dhoma e Shkallës së Dytë, gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet në ankes, Gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, në kuptim të nenit 44 të LKA-së dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, dhe në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar vet gjendjen faktike, dhe ka vendosur meritorisht për çështjen juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 49 LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.713/24 datë 24.05.2024

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,  
Krenar Berisha